



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 janar 2012
Nr. ref.: RK 184/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 23/11

Parashtrues

Pajazit Mulaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Glllogoc, C.
Nr. 150/04, të 29 janarit 2009, dhe të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. Nr. 90/04, të 14 tetorit 2004.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Pajazit Mulaj, me vendbanim në Glllogoc.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Komunale në Glllogoc, C. Nr. 150/04, të 29 janarit 2009, dhe Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 90/04, të 14 tetorit 2004.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa ka të bëjë me shkeljen e supozuar të parashtruesit të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 21 shkurt 2011.
6. Më 2 mars 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 23/11, e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 23/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.
7. Më 9 mars 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Gjykatën Komunale në Glllogoc dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për këtë kërkesë.
8. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 6 maj 1985, Kompania Ndërtimore “Ndërtimtari”, me Vendimin nr. 628, ia kishte ndarë parashtruesit një banesë shoqërore. Banesa i ishte ndarë gjersa ishte në ndërtim e sipër, si rrjedhojë e të cilës parashtruesi nuk kishte mundësi të banonte në të. Pas përfundimit të ndërtimit, banesën e kishte uzurpuar z. I. D.
10. Më 12 qershor 2002, Gjykata Komunale në Glllogoc e miratoi ankesën e parashtruesit për ta poseduar banesën dhe e obligoi z. I. D. ta lironte banesën e parashtruesit (Aktgjykimi C. Nr. 22/201). Z. I. D. ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
11. Më 17 dhjetor 2003, Gjykata e Qarkut e refuzoi ankesën e z. I. D. dhe e miratoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale (Aktgjykimi AC. Nr. 502/2002). Z. I. D. ushtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi, me të cilin kërkonte që Gjykata Supreme t'i anulonte vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta.
12. Më 14 tetor 2004, Gjykata Supreme e Kosovës i anuloi vendimet e Gjykatës së Qarkut (AC. Nr. 502/2002, të 17 dhjetorit 2003) dhe të Gjykatës Komunale (C. Nr. 22/2001, të 12 qershorit 2002), dhe ia ktheu rastin për gjykim gjykatës së shkallës së parë (Rev. Nr. 90/2004). Gjykata Supreme konkludoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk i kishin

konfirmuar, në përputhje me nenin 11 të Ligjit për marrëdhëniet banesore, kushtet sipas të cilave ishte fituar e drejta për posedim të banesës. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta duhej të konfirmonin nëse banesa shoqërore ishte bartur në pronësi private apo ende ishte në pronësi të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

13. Më 24 nëntor 2004, Gjykata Komunale në Glllogoc e refuzoi ankesën e z. I. D. për konfirmimin e të drejtës së tij për shfrytëzim të banesës. Gjykata Komunale konkludoi se kjo çështje ishte gjykuar me vendimet e Gjykatës Komunale (Aktgjykimi C. Nr. 22/2001, i 12 qershorit 2002) dhe të Gjykatës së Qarkut (Aktgjykimi AC. Nr. 502/2002, i 17 dhjetorit 2003).
14. Më 29 janar 2009, pasi Gjykata Supreme ia kishte kthyer rastin, Gjykata Komunale në Glllogoc e shpalli veten jokompetente sepse kjo çështje ishte në kompetencë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për shkak se banesa e kontestuar ishte në pronësi të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Procedura e përmbarrimit

15. Më 15 shtator 2004, Gjykata Komunale lejoi përmbarrimin e vendimeve të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut (E. Nr. 24/04). Z. I. D. parashtrroi ankesë kundër këtij vendimi pranë Gjykatës Komunale.
16. Më 11 nëntor 2004, Gjykata Komunale e refuzoi si të pabazë ankesën e z. I. D.
17. Më 8 dhjetor 2004, Gjykata Komunale në Glllogoc e pezulloi procedurën përmbarrimore pasi e drejta e përmbarrimit ishte anuluar me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 90/04, të 14 tetorit 2004, me ç'rast të gjitha veprimet lidhur me këtë çështje gjyqësore ishin abroguar.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pohon që i është shkelur e drejta e tij për ta shfrytëzuar banesën, siç garantohet me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
19. Parashtruesi gjithashtu pohon që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i 14 tetorit 2004 ishte i pjesshëm. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që edhe vendimi i Gjykatës Komunale në Glllogoc për ta shpallur veten jokompetente është i dyshimtë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Sa u përket pretendimeve të parashtruesit se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës Kushtetuese.
21. Sa i përket Vendimit të kontestuar, C. Nr. 150/04, të Gjykatës Komunale në Glllogoc, të 29 janarit 2009, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit, sipas të cilëve individët që parashtrojnë kërkesë në Gjykatë duhet të tregojnë se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.
22. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është t'ua lejohet autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në

supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803194, vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, vendimi i 28 prillit 2004).

23. Kjo Gjykatë e zbatoi të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI 41/09, i 27 janarit 2010, dhe Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rasti Nr. 73/09, i 23 marsit 2010.
24. Sa i përket këtij rasti, nga parashtruesit shihet qartë se, deri më tani, ai nuk e ka ngritur shkeljen e supozuar të së drejtës së tij për ta poseduar banesën pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, e cila, sipas vendimit të Gjykatës Komunale të 29 janarit 2009, është gjykata kompetente për t'u marrë me këtë çështje. Parashtruesi është dashur të ketë pasur dijeni për këtë informatë kur, me vendimin e 14 tetorit 2004, Gjykata Supreme i anuloi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe të gjitha veprimet e ndërmarra nga gjykatat më të ulëta lidhur me këtë çështje.
25. Prandaj, rezulton që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 (2) të Ligjit.
26. Për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, kërkesa është e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të rregullit 36 (3) (h) të Rregullores së punës, nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 23 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Dr. Gjyljeta Mushkolaj

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani